

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
Cinco Summer sh.p.k

KREU I
Dispozita te Pergjithshme

Neni 1

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar ***Cinco Summer sh.p.k*** do te funksionojë sipas këtij Statuti te përpiluar dhe nënshkruar nga ortakut i vetem i shoqerise ,bazuar ne ligjin Nr.9901,date 14/04/2008.

Neni 2

Emertimi i shoqerise eshte "***Cinco Summer sh.p.k***"

Neni 3

Shoqeria e përcaktuar ne nenin 1 te këtij Statuti krijohet me mjetet ne pronesi private te themeluesit te saj.

Neni 4

Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar ***Cinco Summer sh.p.k*** ne perputhje me vendimin per krijimin e kësaj shoqërie dhe me legjislacionin shqiptar ,rregullon poziten juridike te themeluesit dhe te punonjësve ne shoqeri ,te dhenat me rendesi per qarkullimin juridik ,organizimin,objektin e veprimtarise dhe çeshtje te tjera me rendesi per punen e shoqerise.

Neni 5

Shoqeria ***Cinco Summer sh.p.k*** eshte person juridik shqiptar,dhe fiton personalitet juridik nga data e regjistrimit ne organet perkatese.

Shoqeria ushtron veprimtarine e saj ne përputhje me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e parashikuara ne dokumentet e krijimit te saj,aktin e themelimit dhe ne kete statut.

Neni 6

Selia e Shoqerise eshte Durres Lagjja nr. 1, Rruga Currilave, Objekti me nr. 463/52 Shoqeria mund te ndryshojë seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut të Shoqërisë.

Neni 7

Administratori i shoqërisë do të jetë Enio JAHELEZI.

Neni 8

Shoqeria ka vulen e saj me permbajtjen: Shoqeria me Pergjegjesi te Kufizuar **Cinco Summer sh.p.k** Tirane, Albania.

Neni 9

Shoqeria Cinco Summer sh.p.k ka per objekt te veprimtarise ekonomike:

Lounge bar , me aktivitet 24 ore. Import-eksport materialesh robotike per krijim atmosfere eventesh artistike, aparatura teknologjise LED, sistem ndricimi dhe sistem elektronik i drejtimit te ndricimit te telekomanduar, karrike dhe tavolina banak dhe mobilie te tjera per zhvillim aktiviteti lounge bar , impiante Fone dhe impiante autoporlantesh. Studio artistike, studio televizive.

Neni 10

Shoqeria ushtron veprimtarine e vet te percaktuar ne kete Statut ne teritorin e Republikes se Shqiperise .Per kryerjen e kesaj veprimtarie shoqeria mund te çele dege ,zyra dhe filiale te saj te perfaqesimit brenda dhe jashte vendit ne perputhje me legjislacionin shqiptar dhe te vendit ku eshte hapur.

Neni 11

Shoqeria kryen veprimtarine e saj per te realizuar fitimin e saj duke u mbeshtetur ne parimet e likuiditetit ,sigurise dhe rentabilitetit.

Neni 12

Pjesemarrja ne shoqeri nuk e pengon ortakun te ete pavaresi ligjore ,per veprimtari te tjera dhe per te drejta te tjera pronesie.

Ai nuk pergjigjet per detyrimet e shoqerise qe rrjedhin nga objekti I veprimtarise se saj tek kapitali themelor ku ai ka marre pjese

Neni 13

Ortaku ka keto te drejta kryesore:

- Te merre pjese ne administrimin e veprimtarise se shoqerise ,ne përputhje me kontrten dhe statutin vete ose nepermjet perfaqesuesve te tij.
- Te merre pjese ne rezultatet e veprimtarise se shoqerise ne çdo forme dhe sasi qofte ne perputhe me statutin dhe kontrtaen.
- Te marre pjese ne organet e shoqerise qe jane ose mund te krijohen ,nepermjet perfaqesuesit te tij oser vete.
- Te kerkoje ti jepen te gjitha informatat qe kane te bejne me gjendjen tregtare te shoqerise si dhe te gjitha dokumentet e përpunuara te shoqerise,si bilancet.llogarite ekonomike,etj.
- Te beje propozime dhe ti paraqese ato per shqyrtim para organeve te shoqerise.
- Te emeroje dhe shkarkoje perfaqesuesit e saj ,punonjësit,ekspertin kontabël dhe likuidatoret.
- Te heqe dore nga shoqëria. Heqja dore nga shoqëria nuk liron ortakun nga detyrimet financiare te marra me pare ndaj shoqerise.

Neni 14

Ortaku ka keto detyra kryesore:

- Te marre pjese ne administrimin e shoqerise nepermjet organeve te krijuara prej tij,vete ose nepermjet perfaqesuesve qe krijon ai.
- Ti jape shoqerise informatat e nevojshmeqe kane te bejne me ecurine e veprimtarise se saj.

- Te kryejë shërbimet e nevojshme për arritjen e objektivave të shoqërisë dhe realizimin e funksioneve të saj.

KREU II

Kushtet ekonomike

Neni 15

Veprimtaria e shoqërisë realizohet në bazë të veprimarisë kontabel dhe pasqyrohet në bilancin e saj.

Neni 16

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë lekë). Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributit e tij .

Personi zotëron 100% të kapitalit në shoqëri si ortak i vetëm.

Kapitali i korespondon 1(një) kuote të vetme me vlerë 100.000lekë (njëqintemijë lekë) .

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë.

Neni 17

Në rast zmadhimi të kapitalit themeltar nëpërmjet shtimit të pjesëve të saj ortakut ka të drejtën e rritjes së tij në mënyrë proporcionale.

Neni 18

Pjesët e kapitalit themeltar janë plotësisht të transferueshme në rrugë trashëgimie në rast ndarje pasurie ndërmjet bashkeshortëve dhe paraardhësve a pasardhësve .

Transferimi i pjesëve të kapitalit themeltar duhet të vërtetohet me akt notarial.

Neni 19

Shoqëria në emër të vet është pronare ,përdoruese dhe disponuese e pasurive të saj,për gjithmone në përputhje me qëllimin e objektit të veprimtarisë që ajo kryen.Shoqëria mund të shesë pasuri ose të shfrytëzojë të drejtat e tjera materiale.Ajo mund të ofrojë për garanci edhe pasuri të saj për të marrë kredi bankare.

Neni 20

Shoqëria krijon fonde rezerve ose dhe fonde të tjera të veçanta për zhvillimin dhe nxitjen ekonomike të saj.

Shoqëria disponon mjertet e veta financiare .Detyrimet eventuale që mund të lindin gjatë veprimtarisë së saj ,mbulohen nga fondet rezerve,nga fondet e tjera ose nga shumat suplementare që kur dëshirojnë mund të derdhen prej ortakut,në rastet kur këto detyrime nuk mund të mbulohen nga fondet ekzistuese.

KREU III

Viti financiar,llogaria vjetore,ndarja e fitimit

Neni 21

Viti financiar i Shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor

Neni 22

Llogarite vjetore, inventari, raportet, operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga administratori dhe eventualisht nga eksperti kontabel i autorizuar miratohen nga ortakët i vetëm. Miratimi i dokumentave mbi veprimtarinë vjetore bëhet brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar.

Neni 23

Fitimi neto i realizuar nga shoqëria, mbasi zbriten të gjitha detyrimet si dhe fondet e lena rezerve për nxitjen ekonomike, për investime, për reklamen tregtare etj, e përfiton ortakët i vetëm i kësaj shoqërie.

Neni 24

Bilanci vjetor i shoqërisë nxirret brenda 31 Marsit të vitit pasardhës.

KREU IV

Administrimi

Neni 25

Ortakët i përballon humbjet deri në kufirin e vlerës së tij të derdhur në formën e kapitlit themeltar.

Neni 26

Organi vendimor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme. Mbledhja e Asamblese së Përgjithshme mund të thirret nga Administratori, eksperti kontabel i autorizuar ose likuiduesi.

Neni 27

KUORUMI

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 40% (dyzetë për qind) të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në këtë nen, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shperblimeve,

d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;

e) perfaqesimin e shoqërisë në gjykate dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKB për të pasqyruar ndryshimet në skedën e shoqërisë.

Neni 28

Administrimi i shoqërisë bëhet nga Administratori. Me miratimin e Ortakut të Vetëm të Shoqërisë, zoti Enio JAHELEZI emrohet administrator dhe perfaqësues i Shoqërisë "CAVALLI CLUB" Sh.p.k për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë rizgjedhje. Administratori ka dhe funksionin e perfaqësimit të shoqërisë me të tretet në gjithë veprimtarinë e saj.

Neni 29

Administratori ka të gjitha kompetencat për të kryer të gjitha veprimet në interes të shoqërisë. Dhe në emër të saj nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektivin e veprimtarisë së shoqërisë me përjashtim të atyre kompetencave që ligji nuk i njeh.

Administratori është përgjegjës individualisht ndaj shoqërisë apo të treteve për shkeljet e ligjeve, të statutit, apo për faj të tij gjatë administrimit të shoqërisë.

Neni 30

Kompetencat e administratorit në shoqëri janë:

- Të miratojë planet e llogarise ekonomike pas përpunimit të tyre në kuadrin e veprimtarisë së shoqërisë.
- Të bëjë propozimet e nevojshme në mbledhjet e asamblese, kur lind nevoja e ndryshimit të kapitalit themeltar të shoqërisë.
- Të miratojë aktet normative që përcaktojnë raportet në gjirin e shoqërisë duke përfshirë kuadrin dhe personelin.
- Të përcaktojë strukturën e aparatit të shoqërisë.
- Të krijojë organe të tjera të domosdoshme për realizimin e objektivave të shoqërisë
- Të propozojë në mbledhjen e asamblese së përgjithshme për krijimin e njesive, strukturave si filiale, degë e perfaqësi në qytete të tjera të vendit apo jashtë shtetit.
- Të përgatitë propozimin për pushimin e veprimtarisë së shoqërisë dhe të paraqesë ato asamblese për miratim.
- Të përzgjedhë ekspertet kontabel dhe anëtarët e komisionit të likuidimit dhe të paraqesë propozimet për miratim në asamble.
- Të sigurojë zbatimin e përpikë të vendimeve të asamblese.
- Të përcaktojë numrin e punonjësve të shoqërisë dhe pagat e tyre.

Neni 31

Kontrolli i shoqërisë mund të kryhet nga një ekspert kontabel i autorizuar, i emëruar për tre vite financiare me mundësi rizgjedhje. Ai caktohet nga administratori i shoqërisë. Shkarkimi i ekspertit kontabel të autorizuar vendoset në të njëjtat kushte si emërimi, ose kur bëhet e pamundur kryerja e detyrës.

KREU V

Kohezgjatja e veprimtarisë së shoqërisë

Neni 32

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar. Shkurtimi i kesaj kohezgjatje ne rastin e nje prishje te pershpejtuar te shoqerise ose zgjatja e afatit, duhet te behet me vendim te Ortakut të Vetëm të Shoqërisë

KREU VI

Marredheniet e punes

Neni 33

Mareveshja e punes ne shoqeri rregullohet ne perputhje me vendimin per krijimin e shoqerise,legjislacionn shqiptar dhe me kete statut.

Neni 34

Punesimi i punonjesve ne shoqeri behet ne baze te kontrates kolektive dhe individuale te punes
Ne kontraten e punes rregullohen keto çeshtje:

- Kushtet dhe menyra e marredhenieve ne pune.
- Fillimi i punes se punonjesve dhe caktimi i tyre ne vendin e punes.
- Koha e punes dhe caktimi i kohes se punes.
- Pune jashte kohes normale ,puna ne ditet e pushimit javor ,festave zyrtare.
- Mbrojtja ne pune dhe kushtet e punes.
- Pushimet dhe mungesat.
- Te drejtat detyrimet dhe pergjegjesite e punonjesve per zbatimin e detyrave te punes.
- Paga e punes se punonjesve ,shperblimi i punes dhe shperblime te tjera.

Neni 35

Shoqeria merr persiper te beje sigurimin e te punesuarve prane saj ,ne organet perkatese,duke derdhur rregullisht kontributet ne perqindjet e caktuara sipas dispozitave ligjore ne fuqi.

Neni 36

Per te gjitha mosmarreveshjet,qe mund te lindin,gjate veprimtarise se shoqerise dhe qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim organi kompetent per shqyrtimin e tyre eshte Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

KREU VII

Mbyllja e shoqerise

Neni 37

Veprimtaria e shoqerise mbaron ne afatin e percaktuar ne aktin e themelimit.
Veprimtaria e shoqerise mund te mbyllet edhe kur gjate dy vjeteve te njepasnjeshem veprimtaria e shoqerise nuk rezulton rentabel,ose kur ortaku heq dore nga shoqeria.

Neni 38

Kur shoqeria likuidohet asamblea mbledh komisionin e likuidimit i cili paraqet per miratim bilancin e likuidimit te shoqerise.

Neni 39

Mjetet financiare si dhe çdo pronesi tjetër e fituar si rezultat i veprimtarisë së shoqërisë kur shoqëria likuidohet, i takojnë ortakut të vetëm të saj, pasi të jenë zbritur dhe bërë pagesat për të gjithë kreditorët e shoqërisë.

KREU VIII
DISPOZITA TE FUNDIT


Neni 40

Të gjitha veprimet e shoqërisë regjistrohen në një libër të veçantë që mbahet në selinë e shoqërisë.

Neni 41

Ky statut është hartuar sot me datën 22 Qershor 2021 për Shoqërinë **Cinco Summer sh.p.k**

ORTAKU I VETËM
Enio JAHELEZI

Handwritten signature of Enio Jahlezi in black ink, written in a cursive style.

**AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
Cinco Summer sh.p.k**

Ne Tirane, sot me date 22 Qrshor 2021 , u paraqit personalisht ortaku themelues:

Enio JAHELEZI, i biri i **Ferizit** , datelindja **25/03/1980** , lindur ne _Tropoje , me zotesi te plote juridike per te vepruar, identifikuar me Nr.personal Leternjoftim 032979861,banues në Tirane.

Deklaroj me vullnetin tim te plote e te singert dhe me iniciativen time te lire dhe private mbështetur ne kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe kodin civil ne fuqi,ne ligjin 9901 date 14.042008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", ligjin 9723 date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, te krijoj shoqerine tregtare me pergjegjesi te kufizuar me emertim **Cinco Summer sh.p.k**

KREU I
Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohezgjatja, Objekti

Neni 1
Emertimi

Emertimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar eshte **Cinco Summer sh.p.k**

Neni 2
Forma Juridike

Shoqëria **Cinco Summer sh.p.k** është një shoqëri tregtare, e themeluar nga ortaku i shoqerise, i cili përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulone personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkuara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.Ortakut gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Selia e Shoqerise eshte Durres Lagjja nr. 1, Rruga Currilave, Objekti me nr. 463/52

Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoj filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Ortakut të Shoqërisë.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Shoqeria do te kryejte aktivitetin e meposhtem(vetem nese eshte i përcaktuar)

Lounge bar , me aktivitet 24 ore. Import-eksport materialesh robotike per krijim atmosfere eventesh artistike, aparatura teknologjise LED, sistem ndricimi dhe sistem elektronik i drejtimit te ndricimit te telekomanduar, karrike dhe tavolina banak dhe mobilie te tjera per zhvillim aktiviteti lounge bar , impiante Fone dhe impiante autoporlantesh. Studio artistike, studio televizive.

Neni 5
Kohezgjatja

 1

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një periudhë kohore të pacaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit në regjistrin tregtar. Shkurtimi i kësaj kohezgjatjeje në rastin e një prishjeje të pershpejtuar të shoqërisë ose zgjatja e afatit, duhet të bëhet me vendim të Ortakut të Vetëm të Shoqërisë

KREU II **KAPITALI**

Neni 6 **Kapitali themeltar**

Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 lekë (njëqind mijë leke). Pjesëmarrja e themeluesit në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributit e tij .

Personi zotëron 100% të kapitalit në shoqëri si ortak i vetëm.

Kapitali është i korespondon një 1 kuote të vetme me vlerë 100.000leke (njëqintemijë leke) .

Kontributi i ortakeve mund të jete në para ose në natyrë.

Neni 7 **Transferimi i kapitalit**

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyrë tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kushtet dhe momenti i kalimit të titullit të pronësive mbi kuotën si dhe kushtet e tjera të kalimit ,përfshirë momentin e pagesës së çmimit ,rregullohen nga kontrata .Kontrata për kalimin e kuotës hartohet në formë shkresore dhe noterizimi nuk përben kusht për vlefshmerinë apo regjistrimin e kontratës.Me përjashtim të rasteve kur parashikohet shprehimisht ndryshe nga ligji apo kur palet bien dakort në kontratë,vlefshmeria kalimit të titullit të pronësive mbi kuotat nuk do të kushtëzohet nga kryerja e formaliteteve të ndryshme me efekt deklarativ ,përfshi këtu formalitetet e regjistrimit ose të publikimit të kontratës apo të kalimit të titullit”.

KREU III **ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE**

Neni 8 **Organi Vendimmarres**

Ortaku i vetëm është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë.

Ortaku i vetëm është organi i vetëm vendimmarres i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj. Ortaku i vetëm është përgjegjës për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;



- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 9 **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës për çështje të tjera si:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërblimeve,
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecursisë së veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve,
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë

Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasqyruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 10 **Administrimi**


(1) Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

(2) Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

(3) Personat e mëposhtëm caktohen si Administratorë të parë të shoqërisë deri në emërimin e tyre nga mbledhja e parë e Asamblesë së Përgjithshme.

Të dhënat e identifikimit: dhe specimenët e nënshkrimit:

Administratori i shoqërisë do të jetë Enio Jafelezi, lindur më 25/03/1980, në Tropoje,

3


identifikuar me nr. Letërnjoftimi me nr. 032979861,

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- ë) kryejnë detyra të tjera të percaktuara në ligj dhe në statut.

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakeve edhe në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të sheshe apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Nëse asambleja e përgjithshme emeron me shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkarisht shoqërinë.

Asambleja e përgjithshme, mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë, me shumicë të zakonshme. Padite që lidhen me shpërbllimin e administratorit në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

Neni 12

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 13

Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblesë së Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;

4


ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";
d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

Neni 14

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin në përputhje të plotë me këtë akt themelimin statutin dhe dispozitat e legjislationit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtare dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 15

Mosmarreveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te lindë midis Shoqërisë dhe të treteve, do të jetë kompetente Gjykata Shqiptare.

Ortaku i vetëm i shoqërisë si themelues i saj pasi e lexoi me vëmendje akt themelimin e mesipër dhe duke qenë konform vullnetit të tij e firmosi pa vërejtje.

ORTAKU THEMELUES I SHOQËRISË *Cinco Summer* sh.p.k

Enio JAHELEZI

